



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 24.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.12.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, **N.P.SH. "AFA-ING", Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Instalimi i kamerave në disa Institucione edukative arsimore** me nr. të Prok: **613-20-6340-5-2-1**

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **N.P.SH. "AFA-ING", Suharekë** të dt. 23.12.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Instalimi i kamerave në disa Institucione edukative arsimore** me nr. të Prok: **613-20-6340-5-2-1**

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë **Grup i Operatorëve Ekonomik: "IMPACT "SH.P.K.-DEGA NË KOSOVË; "cimi @ ELECTRONIC " SH.P.K., Z.INDUSTRIALE LIDHJA E PEJËS, -, FUSHË KOSOVË** i datës 18.12.2020 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 18.12.2020;
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, me datë 24.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i Parë:

1. Komisioni për vlersim të ofertave në herën e parë juve si OE ju ka propozuar për kontratë dhe gjatë fazës së ankimit kemi pruar kërkesë për rishqyrtim dhe AK ka rishqyrtuar atë ankese dhe ka marrë vendim që lenda të kthehet në Rivlersim. Komisioni i caktuar për rivlersim të ofertave ka rivlersuar ofertat dhe ka marrë këtë vendim që ende është në fuqi deri sa të perfundon afati i ankimit.

Ky pretendim i juaji është i pabazuar

Pretendimi juaj i dytë, tretë, katër:

2. OE i propozuar për kontratë ka të bashkangjitur katalogun sipas kërkesave të AK, OE nuk ka ofruar asnjë katalog nga me nga dy lloj variante, katalogjet janë të bashkangjitura sipas specifikimit teknik.

Ky pretendim i juaji është i pabazuar

Pretendimi juaj i tretë:

3. Juve si OE nuk ju kemi eliminuar për arsye të inxhinierit por nuk e kemi kuptuar saktë pjesën e eliminimit, neve si AK vetëm ju kemi cekur se qka ka qenë kërkesë e AK. Ju rekomandojmë që të lexoni perseri letren standarde për Eliminim. Të bashkangjitur kemi letren standarde për eliminim

Ky pretendim i juaji është i pabazuar

AK, drejtoria e prokurimit ka shpallur fituesin e ofertës me qmim më të lirë të përgjegjshëm

AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

 Adem Duriqi
Drejtore e Prokurimit

B42 - Letër standarde për [tenderuesin] [kandidatin] e eliminuar ¹

KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, SHQIPERIA 14000 LIPJAN

Data: 18.12.2020

N.P.SH. "AFA-ING" Suhareke

Nr. i prokurimit:	613-20-6340-5-2-1
Nr i brendshëm	613 020 145 521

Titulli: Instalimi i kamerave në disa Institucione edukative arsimore

I/e nderuar(a) N.P.SH. "AFA-ING"

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

[Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në [dosjen e tenderit] [dokumentet parakualifikuese]. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është administrativisht i papërgjegjshëm:
ARSYETIM

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

→ 1. Katalogu nuk i permbush kërkesat e AK siq eshte kerkuar ne NJK dhe TD te bashkangjitur keni pjesen e katalogut qe nuk eshte ne baze te specifikave te kerkuara.

2. Ne kerkese te AK tek kapaciteti teknik dhe profesional Kerkesa 2 eshte kerkuar

a). Nje inxhinier master apo bachelor i diplomuar i Elektroteknikes te jete i angazhuar edhe ne te drejte te menagerit per kete projekt b) Nje inxhinier bachelor apo master i shkencave kompjuterike, c) Min 2 puntor te certifikuar nga prodhuesi i kamerave.

→ Sqarim: Ju mungojne 2 puntort e certifikuar sipas kerkeses se AK, ju si OE keni dorzuar deshmi per certifikatat e leshuara nga prodhuesi i kamerave por keto certifikata i kan stafi profesional si inxhinieri i elektroteknikes dhe inxhinieri i shkencave kompjuterike qe bjen ne ndesh me kerkemat e AK.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Adem Duriqi,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

(Nënshkrimi)

¹ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).